

Trajnimi dhe Mentorimi i Trajnuesve-Infermierë mbi “Procedurat Standarde Infermierore për Shërbimet e Kujdesit në Banesë”.

I. SFONDI

“Shëndet për të Gjithë” (HAP) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i Qeverisë Zvicerane, që zbatohet në Shqipëri që nga viti 2015. Qëllimi i përgjithshëm i tij është që popullsia shqiptare të përfitojë shëndet më të mirë falë Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP) më të përmirësuar dhe gjithëpërfshirës. Që nga 1 prilli 2023, Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Tropicale (SwissTPH) dhe Qendra HAP po zbatojnë Fazën e Konsolidimit (Faza 3) të HAP.

Në mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) për zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit të KSHP 2020–2025, HAP ka dizenuar dhe pilotuar një model shërbimi të Kujdesit Shëndetësor në Banesë (KSHB) i cili është miratuar nga MSHMS në tetor 2021. Aktualisht HAP po mbështet shtrirjen e këtyre shërbimeve në 150 Qendra Shëndetësore (QSH) të shtrira në 4 Operatorët Shëndetësor Rajonal: Vlorë, Tiranë, Elbasan and Shkodër

Një aspekt kyç i mbështetjes nga HAP ka qenë trajnimi i trajnuesve-infermierëve në këto QSH, të cilët më pas do të trajnojnë kolegët e tyre. HAP do të vazhdojë të mbështesë përmirësimin e kompetencave pedagogjike dhe teknike të trajnuesve-infermierë nëpërmjet një qasjeje të kombinuar që përfshin trajnim dhe mentorim individual.

Për këtë qëllim, HAP kërkon një Konsulent të aftë për të realizuar trajnimin dhe mentorimin e trajnuesve-infermierë. **Konsulenti mund të jete një organizatë, kompani apo individ.** Me konsulentin e përzgjedhur do të nënshkruhet një kontratë kuadër. Kjo konsulencë do të kontribuojë në sigurimin e një ofrimi të qëndrueshëm dhe cilësor të trajnimeve në të gjitha QSH-të.

II. QËLLIMI

Kjo konsulencë ka dy qëllime kryesore:

1. Të forcojë aftësitë pedagogjike themelore të trajnuesve-infermierë nëpërmjet një trajnimi tre-ditor të akredituar;
2. Të përmirësojë aftësitë teknike të trajnuesve-infermierë nëpërmjet mentorimit në vend, ndërsa ata realizojnë trajnimin lidhur me procedurat standarte infermierore të nevojshme për ofrimin e KSHB.

III. METODAT DHE QASJET

Për të përmbushur këtë mandat, Konsulenti duhet të mbështesë trajnuesit-infermierë në dy faza:

- 1) Fillimisht, duke i trajnuar ata në klasë në grupe prej 15 pjesëmarrësish, me fokus në aspektet didaktike dhe pedagogjike të trajnimit “Procedurat standarte infermierore të nevojshme për ofrimin e KSHB”; dhe, 2) duke i mentoruar ata gjatë realizimit të këtij trajnimi me kolegët e tyre. Ky proces përshkruhet më poshtë në mënyrë më të detajuar.

Faza 1: Trajnim i akredituar Pedagogjik Tre-Ditor

- Konsulenti duhet të mobilizojë dy ekspertë për të përgatitur dhe ofruar një seri trajnimesh pedagogjike të akredituara tre-ditore në klasë. Trajnimi do të ofrohet për disa grupe



trajnues -infirmierë. Çdo grup duhet të ketë 10-15 infermierë-trajnues, por jo më pak se 10. Një ditë trajnimi do të zgjasë 5 orë efektive.

- Ky trajnim fokusohet në parimet e mësimdhënies për të rriturit, përdorimin e mjeteve didaktike, ushtrime praktike dhe prezantime nga pjesëmarrësit. Temat klinike, që do të përdoren si shembuj përfshijnë: kateterizimi urinar, kujdesi për stomën dhe trakeostominë, lavazhi i veshit, kujdesi për plagët e presionit, kateterizimi IV dhe venopunktura.
- Trajnimet do të zhvillohen në Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër.

Faza 2: Mentorim në Vend

- Konsulenti duhet të mobilizojë një ekspert për të mentoruar trajnuesin-infirmier gjatë trajnimeve që trajnuesit-infirmierë do të realizojnë me kolegët e tyre. Një ditë mentorimi do të zgjasë 5 orë efektive
- Eksperti do të jetë i pranishëm në vend gjatë ditës së trajnimit për të vëzhguar infermierët-trajnues dhe, nëse kërkohet, do të ofrojë ndihmë gjatë praktikës me manekinet dhe pajisje të tjera.. Në fund të çdo ditë trajnimi, eksperti do të kryejë një takim të shkurtër me trajnuesin-infirmier, për të dhënë komente dhe sugjerime lidhur me ofrimin e trajnimit. Një raport i shkurtër që përmbledh vëzhgimet dhe rekomandimet për secilin trajnues-infirmier do t'i dorëzohet HAP-it.
- Mentorimet do të ofrohen në Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër.
- Temat e trajnimeve praktike që do të realizojnë trajnuesit-infirmierë me kolegë e tyre janë procedurat standarte infermiore më poshtë: Vlerësimi i përgjithshëm infermior, matja e shenjave jetësore, Kujdesi për kavitetin oral, kateterizimi urinar, kujdesi për stomat/trakeostominë, sondimi nazogastrik, përdorimi i inhalatorëve dhe pompave, terapia me oksigjen; Kujdesi për plagët kronike dhe malinje, këmba diabetike, limfedema, kateterizimi venoz, venopunktura, përdorimi i insulinës. Materiali referues është Manuali i Procedurave Standarde të Infermiore, i disponueshëm në: <https://ëëë.hap.org.al/en/procedurat-infermiore-KSHB/>. Siç u përmend më herët, infermierët e angazhuar si trajnues kanë ndjekur më parë sesione trajnimi mbi këto procedura standarte klinike infermiore.

Në këtë kuadër Konsulentit do të:

- Mobilizojë të paktën tre ekspertë për ofrimin e kësaj konsulence
- Përvetësojë përdorimin e materialeve trajnuese të listuara në Aneksin 1, si dhe Manualin e Procedurave Standarde Infermiore, i disponueshëm në: <https://ëëë.hap.org.al/en/procedurat-infermiore-KSHB/>.
- Hartojë një agjeendë paraprake për trajnimin pedagogjik, e cila do të diskutohet dhe finalizohet me HAP-in.
- Përgatisë mjetet edukative përkatëse për trajnimin pedagogjik, duke përfshirë prezantime PowerPoint, skenarë simulimi, si dhe formularë vlerësimi dhe raporte të gjetjeve për secilin trajnues-infirmier gjatë procesit të mentorimit.



- Të jetë përgjegjës për akreditimin e Trajnimit Pedagogjik tre-ditor, duke përfshirë pagesën e tarifës së akreditimit në Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Shërbimet Shëndetësore dhe Sociale (ASCK). Kjo kosto do të rimbursohet nga HAP pas paraqitjes së faturave përkatëse të lëshuara nga ASCK dhe mandat-pagesës.
- Hartojë një kalendar paraprak në bashkëpunim me HAP-in për të dy aktivitetet: trajnimin pedagogjik dhe sesionet e mentorimit.
- T'i dorëzojë HAP-it certifikatat e firmosura pas çdo sesioni trajnimi, duke përfshirë emrin e plotë të çdo pjesëmarrësi, datat, së bashku me listën përkatëse të pjesëmarrjes të firmosur. Këto dokumente do të bashkëfirmosen nga HAP dhe do t'u shpërndahen pjesëmarrësve.
- Sigurojë transportin e ekspertëve drejt dhe nga vendi i trajnimit.
- Sbjajë komunikim të rregullt me stafin e HAP-it përgjegjës për zbatimin e KSHB.
- Informojë HAP-in menjëherë për çdo problem apo vonesë që mund të ndikojë në realizimin në kohë të detyrave të parashikuara në këto Terma Reference.

Roli i HAP

- Të rishikojë dhe të miratojë kalendarin e trajnimeve dhe mentorimit të propozuar nga Konsulenti.
- Të rishikojë dhe të miratojë agjendën e trajnimit pedagogjik 3-ditor të propozuar nga Konsulenti.
- T'i vërë në dispozicion konsulentit manualët e përdorimit për modelet (manekinët) mësimore në të dyja gjuhët, anglisht dhe shqip.
- Të sigurojë paraprakisht prezantimet PoëerPoint për sesionet e trajnimit që do të zhvillohen nga infermierët-trajnues për kolegët e tyre.
- Të vërë në dispozicion agjendën e trajnimit për "Procedurat Standarde Infermierore KSHB", që do të zhvillohet nga trajnues-infermierë me kolegët e tyre.
- Pas marrjes së certifikatave të firmosura nga Konsulenti, HAP do të bashkëfirmosë dhe do t'i shpërndajë certifikatat për pjesëmarrësit në trajnim
- Të ofrojë mbështetje logjistike gjatë trajnimit, duke përfshirë akomodimin dhe vaktet për ekspertët, si dhe vaktet për trajnerët dhe pjesëmarrësit.
- Të rimbursojë Konsulentin për shpenzimet e transportit të ekspertëve, pas përfundimit të shërbimit.

IV. KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KONSULENTIT

A. Eksperiencë në Edukimin në vazhdim: Konsulenti (OJQ, kompani ose individ) duhet të dëshmojë eksperiencë në fushën e edukimit profesional, veçanërisht në sektorin e kujdesit shëndetësor.



B. Profili Profesional i Ekspertëve: Ekspertët e angazhuar nga Konsulenti duhet të kenë formim profesional "Infermier". Të jenë aktivë në role akademike, si mësimdhënie ose mentorim në Fakultetin e Infermierisë dhe/ose të kenë të paktën 3 vite përvojë pune si infermier/e klinik/e.

- Eksperiencë në Trajnim: Ekspertizë të fortë pedagogjike dhe klinike në infermieristikë. Përvoja e dëshmuar në zhvillimin dhe ofrimin e programeve trajnuese, veçanërisht atyre që përfshijnë metodologji të të nxënit për të rritur dhe zhvillim të aftësive klinike infermiore.
- Aftësi në Mentorim dhe Mbështetje: Përvojë të dokumentuar në vëzhgimin, mbështetjen dhe dhënien e feedback-ut konstruktiv stafet shëndetësor.
- Njohuri mbi Pajisjet Trajnuese: Konsulentët duhet të jenë të aftë të përdorin në mënyrë efektive pajisjet trajnuese të listuara në Aneksin 1.
- Njohuri paraprake mbi "Manualin e Procedurave Standarde të Infermierisë për Ofrimin e Shërbimeve në Shtëpi" do të konsiderohet një avantazh.

V. KOHËZGJATJA

Qershor 2025 – Mars 2026

VI. DOKUMENTET QË DUHET TË DORËZOHEN

Pas çdo trajnimi pedagogjik të akredituar, Konsulenti duhet të dorëzojë pranë HAP:

- Një raport përmbljedhës (i firmosur dhe në kopje fizike dhe elektronike), që përfshin një përmbljedhje të punës së kryer, vëzhgime dhe rekomandime, si dhe dokumentim fotografik të trajnimit
- Agjendën e aktiviteteve të trajnimit pedagogjik
- Një formular vlerësimi për secilin trajnues-infermier dhe gjetjet nga ky vlerësim
- Kalendarin e aktiviteteve
- Certifikatat e trajnimit
- Foto nga trajnimet
- Listë e pjesëmarrjes të dorëzuar në ASCK
- Listë-prezencat origjinale të trajnimit

Pas çdo dite të mentorimit, Konsulenti duhet të dorëzojë HAP-it:

- Një raport përmbljedhës (i firmosur dhe në kopje fizike dhe elektronike), që përfshin një përmbljedhje të punës së kryer, vëzhgime dhe rekomandime.
- Një formular vlerësimi për secilin infermier-trajner dhe gjetjet nga ky vlerësim
- Kalendarin e aktiviteteve
- Foto nga aktivitetet

Aneksi 1: Lista e moulazheve dhe materialeve mësimore në dispozicion

- Moulazh - Krah IV me shumë vena
- Moulazh – Kateterizimi urinar për mashkull/femër



- Moulazh – Plagët dekubituse
- Moulazh – Sondimi gastrik dhe trakeostomi
- Sondë nazogastrike Levine: 12 Fr; 14 Fr; 16 Fr; 18 Fr
- Kateter Foley prej silikoni Nr. 10 Fr, 12 Fr, 14 Fr, 16 Fr
- Metër për matjen e plagëve
- Stetoskop
- Aparat tensioni me manshetë për të rritur
- Pulsoksimetër
- Penë insuline
- Aparat nebulizator
- Pajisje për ushtrime frymëmarrjeje
- Pajisje për lavazhin e veshit
- Qese për klizmë
- Elektrokardiograf (EKG)
- Pajisje pneumatike për limfedemë